



SYLLABUS I LËNDËS “ PENOLOGJIA”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti juridik
Titulli i lëndës:	Penologjia
Programi:	Juridik i përgjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II, semestri: VI
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Fakulteti Juridik
Mësimdhënësi i lëndës:	Enver Buçaj Prof.Asoc.Dr
Të dhënat kontaktuese:	enverbuçaj@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	Lënda e Penologjisë përfshinë trajtimin e problemeve themelore të shkencës së Penologjisë bashkëkohore. Në kuadër të saj paraqiten dhe analizohen njësitë e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e njohurive themelore dhe të avancuara për studentë që kanë të bëjnë me të drejtën e ekzekutimit të sanksioneve penale, siç janë: Kuptimi dhe lënda e studimit; zhvillimi historik i reagimit ndaj kriminalitetit; sanksionet penale dhe ekzekutimi i tyre; problemet themelore të ekzekutimit të sanksioneve penale, procesi i riedukimit të personave të dënuar etj.
Qëllimi i lëndës:	Të mësuarit e kësaj lëndë dhe elaborimi i saj ka për qëllim që studentëve t’u ofrojë dhe thellojë njohuritë kryesore mbi kuptimin e penologjisë dhe të drejtën për ekzekutimin e sanksioneve penale. Studentet duhet të njoftohen se kriminaliteti është një dukuri që paraqet tërësi të veprimeve dhe sjelljeve kundër ligjore dhe të dëmshme të terë shoqërisë. Po ashtu trajtimet në kuadër të kësaj lënde do të ndihmojnë që studentët të njoftohen me njohurit e përgjithshme mbi penologjinë. Gjatë shtjellimit dhe ligjërimit të kësaj lënde do të përdoren disa metoda të cilat janë më të përshtatshme për ofrimin e materies studentëve dhe aftësimin e tyre që ti kuptojnë nocionet dhe përmbajtjet kryesore. Kësisoj do të aplikohet metoda e mësimdhënies aktive dhe inter aktive që do të thotë eksplorimi dhe interpretimi i çështjeve fundametale të kësaj lënde duke u ofruar studentëve,shpjegime, të dhëna e informacione esenciale dhe aktuale mbi penologjinë dhe shkaqet e tyre. Njëheri kjo metodë nënkupton edhe kyçjen aktive

	të studentëve në debate dhe trajtime të çështjeve që konsiderohen me interes të veçantë.		
Rezultatet e të nxënit:	<p>Pas përfundimit të studimit të kësaj lëndë, studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë se fenomeni dinamik dhe kompleks i penologjisë është një nga problemet me aktuale dhe preokupuse për shoqërinë bashkëkohore. - Të formojnë konceptin se shtimi i sjelljeve kriminale, në veçanti i disa formave të manifestimit të kriminalitetit , shtron nevojën për thellimin e studimeve rreth njohjes së shkaqeve dhe faktorëve që e kushtëzojnë paraqitjen e kriminalitetit në shoqëri. - Të njohin bazën juridike duke i'u qasur analizës së dispozitave juridike pozitive (de lege lata) dhe duke marrë parasysh nevojën për plotësimin dhe ndryshimin e infrastrukturës ligjore nga kjo fushë (de lege ferenda). <p>Të pajisen me aftësi të mjaftueshme për të identifikuar natyrën dhe karakteristikat e kriminalitetit në shoqëri dhe problemet themelore te ekzekutimit te sanksioneve penale dhe penologjinë moderne. Gjithashtu ti kuptojnë rregullat, konventat ndërkombëtare dhe ligjet vendore për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe trajtimin e te burgosurve. E tërë kjo bëhet me qëllim që në vendet e tyre të punës në të ardhmen të jenë të përgaditur që të reagojnë me sukses dhe profesionalizëm ndaj dukurive anti shoqerore.</p>		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15 javë	15
Punë praktike	3	1	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/5	5
Ushtrime në terren	0	0	0
Kollokfiume, seminare	2	2	2
Detyra të shtëpisë	1	1/1	1
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45

Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30																												
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	1/2	2																												
Projektet, prezantimet ,etj	2	2	2																												
Totali			150 orë (4 ECTS)																												
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Po ashtu do të përdorën edhe metoda e studimit të rasteve kriminale,metoda e interpretimit të dispozitave ligjore pozitive,metoda e analizës së lëndëve gjyqësore ose të rasteve të prezantuara në masmedia apo raporte të organizatave qeveritare ose joqeveritare mbi dukuritë aktuale të kësaj dukurie në botë apo në rajon.</p> <p>Në trajtimin dhe shpjegimin e problemeve të tilla do të përdorim edhe metoda dhe teknika tjera të mësimdhënies të cilat janë më adekuate dhe më të favorshme për përmbajtjet konkrete. Kështu veçmas do të organizohen debate,do te aplikohen teste, kolokviume, ese dhe seminare të cilat do ti nxisin studentet që në mënyrë aktive dhe me vetë iniciativë të kyçen në procesin mësimor, në nxënien dhe avancimin e materies së kësaj lënde mësimore. Si formë e angazhimit shtesë do të përgatitet edhe një projekt hulumtues me studentë.</p>																														
Metodologjia e vlerësimit:	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nota</th> <th>-</th> <th>Points</th> <th>Përshkrimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10</td> <td>A</td> <td>91–100 %</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>B</td> <td>81 – 90 %</td> <td>Shumë mire</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>C</td> <td>71 – 80 %</td> <td>Mirë</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>D</td> <td>61 – 70 %</td> <td>Kënaqshëm</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>E</td> <td>51 – 60 %</td> <td>Mjaftueshëm</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>F</td> <td>00 – 50 %</td> <td>Nuk kalon</td> </tr> </tbody> </table>			Nota	-	Points	Përshkrimi	10	A	91–100 %	Shkëlqyeshëm	9	B	81 – 90 %	Shumë mire	8	C	71 – 80 %	Mirë	7	D	61 – 70 %	Kënaqshëm	6	E	51 – 60 %	Mjaftueshëm	5	F	00 – 50 %	Nuk kalon
Nota	-	Points	Përshkrimi																												
10	A	91–100 %	Shkëlqyeshëm																												
9	B	81 – 90 %	Shumë mire																												
8	C	71 – 80 %	Mirë																												
7	D	61 – 70 %	Kënaqshëm																												
6	E	51 – 60 %	Mjaftueshëm																												
5	F	00 – 50 %	Nuk kalon																												

Literatura	
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> • Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2014; • Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale ne Republikën e Kosovës; • Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës; • Kodi Penal i Republikës se Kosovës; • Kodi i Procedurës Penale i Republikës se Kosovës; • Ligji për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit kibernetik;
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Konventa kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese; • Konventa evropiane për parandalimin torturës, trajtimit dhe dënimit johuman ose degradues; • Rregullat minimale standarde te OKB-se për trajtimin të burgosurve; • Konventa e te drejtave te fëmijëve , OKB 20 nëntor 1989;

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtime hyrëse në penologji - kuptimi dhe lënda e penologjisë - metodat e penologjisë - raporti i penologjisë me shkencat tjera 	
<i>Java e dytë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Reagimi ndaj kriminalitetit gjatë historisë - Kuptimi dhe rëndësia - Format e reagimit ndaj kriminalitetit - Reagimi privat - Reagimi publik 	
<i>Java e tretë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Teoritë mbi bazën juridike dhe qëllimin e ndëshkimit -dënimit - testite idealiste dhe metafizike - pikëpamja e drejtësisë hyjnore - teoritë e kontratës shoqërore - teoritë juridike normativiste - teoritë sociologjike - teoritë mbi qëllimin e ndëshkimit 	

	<ul style="list-style-type: none"> - teoritë absolute dhe relative mbi qëllimin e ndëshkimit - teoritë bashkëkohore 	
<i>Java e katërt:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Sanksionet penale dhe ekzekutimi i tyre; - Kuptimi dhe format e sanksioneve Penale; -Sanksionet penale sipas legjislacionit penal të Republikës e Kosovës; - Sanksionet penale sipas Kodit penal të Kosovës; - Zëvendësimi i burgimit me urdhër për pune ne dobi të përgjithshme; - Vërejtja e gjykatës - Masat e trajtimit te detyrueshëm - Sanksionet penale sipas kodit të drejtësisë për te mitur ne Kosovë; 	
<i>Java e pestë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Karakteri dhe llojet e sanksioneve penale para paraqitjes së dënimit me burg; - Dënimet me burgim dhe ekzekutimi i tyre; - Sistemet kryesore të ekzekutimit të dënimit me burgim; 	
<i>Java e gjashtë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Roli i organizatave dhe asociacioneve ndërkombëtare për zhvillimin dhe përsosjen e ekzekutimit te sanksioneve penale; 	
<i>Java e shtatë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Problemet themelore të ekzekutimit të sanksioneve penale në penologjinë moderne; - Ekzekutimi i dënimeve me burgim dhe tretmani i të burgosurve; - procesi i riedukimit dhe ri-integrit; - klasifikimi i personave të dënuar klasifikimi dhe kategorizimi i institucioneve korrektuese; 	
<i>Java e tetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Mjetet dhe metodat e tretmanit të dënuarve me burgim; - Puna e personelit me të dënuarit; - metodat e tretmenit grupor me personat e dënuar; 	Kollokvijumi I
<i>Java e nëntë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i ekzekutimit te sanksioneve penale; - struktura e organeve dhe 	

	<p>shërbimeve kryesore mbi organizimin e sanksioneve penale;</p> <ul style="list-style-type: none"> - struktura dhe organizimi i brensheshëm i institucioneve korrektuese; 	
<i>Java e dhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Perimet themelore mbi ekzekutimin e dënimit me burgim - rëndësia dhe llojet e parimeve 	
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Pozita e personave të dënuar gjate qendrimit në institucionet korrektuese; - fillimi i ekzekutimit të dënimit me burgim; - beneficionet e të dënuarve gjate ekzekutimit të dënimit me burgim - transferimi, pezullimi dhe lëshimi ne liri i personave të dënuar; 	
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Ekzekutimi i denimeve alternative; - Ekzekutimi i denimeve plotesuese; - Ekzekutimi i denimeve të tjera; - Ekzekutimi i sanksioneve ndaj të miturve; - Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve; - Ekzekutimi i masave të diversitetit ndaj të miturve; - Llojet e masave edukative; - Masat edukative institucionale; - Ekzekutimi i denimeve ndaj të miturve; 	
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Ekzekutimi i denimeve të vendimeve penale në Shqipëri; - ekzekutimi i dënimit me burgim; - ekzekutimi i vendimeve të tjera penale; - Ekzekutimi i denimeve me gjobë; - Ekzekutimi i masave mjeksore; - Ekzekutimi i masave edukuese; 	
<i>Java e katëmbëdhjetë:</i>	<p>Rregulloret, konventat ndërkombëtare dhe ligjet vendore për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe trajtimin e të burgosurve</p>	
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kollokvijumi II	



Studentët janë të obliguar :

- Të respektojë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve.
- T'i përmbahen të gjitha rregullave edukativo-arsimore.
- Plagjiatura dhe fenomenet e ngjashme mashtruese do të ndëshkohen sipas akteve juridike në fuqi.